



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 100, datë 04.09.2020,

**“PËR
ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “TIRANA AGRIKULTURË” SH.P.K”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b” dhe pika 1.6, shkronja “b”, nenit 54, shkronja "d" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 81, pika 1, shkronja “ë”, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar, Vendimit nr. 48, datë 3.5.2019, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e shoqërisë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe miratimin e akteve të themelimit”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, nenit 13, të Statutit të shoqërisë tregtare “Tirana Agrikulturë” sh.p.k., me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Tirana Agrikulturë” shpk.,

V E N D O S I:

1. Rritjen e kapitalit të shoqërisë “Tirana Agrikulturë” shpk, me anë të kontributit në para nga ortaku i vetëm Bashkia Tiranë, në shumën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekë, duke e rritur kapitalin e kësaj shoqërie në vlerën e përgjithshme prej 5.000.100 (pesë milionë e njëqind) lekë.
2. Vlera nominale e kuotës pas zmadhimit të kapitalit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, bëhet 5.000.100 lekë/kuotë.
3. Zmadhimi i kapitalit të pasqyrohet edhe në nenin përkatës të Statutit të shoqërisë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k.
4. Ngarkohen administratori i shoqërisë që të njoftojë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për zmadhimin e kapitalit, si dhe Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Tiranë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të kësaj shoqërie.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e miratuara në Programin e Projekte Zhvillimi, art 232 parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020.

6. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, shoqëria “Tirana Agrikulturë” sh.p.k, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.

7.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU